



Drejtuar: Shoqërisë «Infosoft Office» shpk
Adresa: Tiranë Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës Km 8.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit e zgjedhur në bazë të Nenit 30 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV, neni 33 është **“Procedurë e hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje materiale kancelarie, letër, bojra për printera, fotokopje dhe plotera për Bashkinë e Tiranës, për vitin 2017”**.

Fondi limit: 15.052.388 (pesëmbëdhjetë milion e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Të ardhura – të vëna në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr.84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **12.06.2017 ora 11.00**

Publikime të mëparshme: *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 19 datë 15.05.2017.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “IT GJERGJI KOMPJUTER” shpk
NUIS- K81503063B

Vlera e ofertës pa TVSH është **10,499,111 (dhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë.**

2. Operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” shpk

NUIS- K21605003M

Vlera e ofertës pa TVSH është **11,429,277.21** (njëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e një) lekë.

3. Operatori ekonomik “Colombo” shpk

NUIS- K36608208V

Vlera e ofertës pa TVSH është **12,975,000** (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

4. Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk

NUIS- J62426002Q

Vlera e ofertës pa TVSH është **14,599,711** (katërmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

1. Operatori ekonomik “IT GJERGJI KOMPJUTER” shpk s’kualifikohet.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme.

Në mbështetje të nenit 56 të ligjit Nr 9643 dt 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si edhe Kreut VII neni 66 pika 5 e VKM Nr. 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, vijoi me verifikimin nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me cmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, nga ku konstatoi se operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter“ shpk, rezultoi të ketë ofertë anomalisht të ulët.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Mbështetur të nenit 56 të ligjit Nr 9643 dt 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si edhe Kreut VII neni 66 pika 5 e VKM Nr. 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, vendosi ti kërkojë operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter“ shpk të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë me shkrim brenda 3(tre) dite pune, shpjegimet për elementët e vecanta të ofertës për te vijuar më tej me procedurën.

Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter“ shpk i është pergjigjur shkresës së Autoritetit Kontraktor me anë të shkresës me Nr. 26136, date 06.07.2017 duke sqaruar ofertën anomalisht të ulët.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter“ shpk për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka bërë asnjë argumentim për elemente të vecanta të ofertës për kushte favorizuese që ka ofertuesi për furnizimin e mallrave cmimet e blerjes, psh fatura blerje apo kontrata me furnitorët, të cilat bëjnë të kuptojnë gjithashtu edhe avantazhin që subjekti ka në furnizime krahasimisht me kompanitë e tjera, dhe rrjedhimisht mundësinë për të ofruar cmime

shitje shume me te ulta, ska argumentim mbi origjinalitetin e mallrave te propozuara nga ofertuesi apo mbi zbatueshmerine e detyrimeve qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes ne vendin ku do te sigurohet furnizimi.

Pra operatori ekonomik ka paraqitur thjesht oferten pa bere asnje argumentim te saj.

Sa me siper operatori ekonomik nuk ka argumentuar oferten anomalisht te ulet dhe per rrjedhoje komisioni i vleresimit te ofertave ne mbeshtetje te pikes 2 te Nenit 56 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" vendos te refuzoje oferten e operatorit ekonomik "IT Gjergji Kompjuter pasi ajo nuk eshte argumentuar nga operatori ekonomik.

Në dokumentat standarte te tenderit, seksioni 3 "**Ofertat anomalisht të ulëta**" pika 3.3, përcaktohet se: *"nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën"*.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", pas konstatimit të **mosargumentimit të ofertës anomalisht të ulët** vendosi ta **shpallë të pavlefshme këtë ofertë**, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik "Interlogistic" shpk s'kualifikohet.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*" pika 2.2, nenparagrafi "3", përcaktohet se: "*Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:[...] Vërtetim lëshuar nga Komuna ose Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017.*"

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik në lidhje me këtë pikë u konstatua se operatori ekonomik "Interlogistic" shpk ka paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri vetem vërtetimin Nr.131578/1, date 07.06.2017 nga Bashkia Tiranë ku operatori ekonomik ka seline qëndrore ndërkohë që vihet re se nuk është paraqitur vërtetim per shlyerjen e taksave vendore per vendet e tjera te ushtrimit te aktivitetit.

Nga verifikimi ne detaj i Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "INTERLOGISTIC" shpk, rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitet dhe ne qytetet Vlore Himare, Spile, Shtetitorja ne Spile ,Sarande prane hotel Porto Eda, Fier, Lushnje Lagja "Kongresi", Lac Rruga Erion Hoxha, Lagja Nr.3, pall 43, Lezhe Lagja "Beslidhja", Pallati 113m etj.

Sa me siper cituar ky operator ekonomik eshte aktiv dhe operativ ne keto adresa dhe detyrimisht duhet te paguaje detyrimet vendore prane pushtetit vendor ne qytetet perkatese ne zbatim te Ligjit 9632, date 30.10.2006 per "Sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) dhe ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor ne dokumentat e tenderit.

Në nenin 12 pika 6 e ligjit Nr 9632, date 30.10.2006 per "Sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) përcaktohet se: "*Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një*"

vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

Pra sa me sipër nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore **të parashikuara nga Pushteti Vendor**” e cila nënkupton se operatori ekonomik që ka interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore jo vetëm nga pushteti vendor ku ka selinë e tij por edhe nga pushteti vendor ku ai ka vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit.

Në nenin 46 pika 1 e ligjit Nr. 9643 dt 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht se: ”Operatorët ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që AK i vlerëson të nevojshme për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jo diskriminuese”.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 53 pika 3 e ligjit Nr 9643 dt 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikohet se: “Autoriteti Kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” si edhe në mbështetje të VKM Nr.1 dt 10.01.2007 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) Kreu V pika 4/ç ku citohet se: “Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit.....”.

Komisioni i vlerësimit të ofertave sa me sipër cituar konkludon se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për shlyerje e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranës; ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkitë e tjera ku ushtron aktivitet.

2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*” pika 6,përcaktohet se:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra **për çdo artikull të kërkuar në preventiv**.Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave me datë 12.06.2017 ora 11:00 mori ne dorezim mostrat e paraqitura në Bashkinë e Tiranës nga operatori ekonomik “Interlogistic” shpk dhe konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson te gjithë mostrat e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Përkatësisht mungon artikulli boje fotokopje percaktuar si me poshte:

1. Xerox Eörk Centre 5021 006R01573

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006

“Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

Pra operatori ekonomik Interlogistik shpk nuk ka paraqitur mostrat për të gjithë artikujt e kërkuar në preventiv duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 8.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Colombo” shpk s’kualifikohet.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*” pika 6, përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për çdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim”.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave me datë 12.06.2017 ora 11:00 mori në dorezim mostrat e paraqitura në Bashkinë e Tiranës nga operatori ekonomik “Colombo” shpk dhe konstatoi se operatori ekonomik nuk plotëson të gjithë mostrat e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Përkatësisht mungojnë artikujt sa më poshte

1. Xerox Work Centre 5021 006R01573
2. Dosje me llastik ,prespan trashesia e kartonit 450 gr,25x35 cm
3. Portamina metalike 0.5 mm
4. Portamina metalike 0.7 mm
5. Toshiba T281CEKE-281 (BLK) 6AK00000034
6. Toshiba T281CEKE-281 (Y/M/C) 6AK00000845/4/3
7. A3 LEXMARK MS911 de 54G0H00
8. Xerox Eëorkcentre 7225 (c/m/y) 006R01458/9/60
9. HP laser Jet 3800 dtn set Q6470A/Q7581/2/3A
10. Kyocera Task alfa 2200 TK-4105
11. Canon 511 Cl 2972B001
12. Toshiba E studio 3540 Black T-FC25-K
13. Toshiba E studio 3540 M/Y/C T-FC25-M / T-FC25-Y / T-FC25-C
14. Ploter Canon IPF 770 6704B001/6705B001/6706B001/6707B001/6708B001
15. Kyocera 6525 TK475
16. Ploter Canon IPF 750 + MBK 0894B001AA/ 0895B001AA/ 0896B001AA/ 0897B001AA/0898B001AA
17. Oliveti XP 11 blk, B0288Q
18. Xerox WC Pro 610, 6R833

Pra operatori ekonomik Colombo shpk nuk ka paraqitur mostrat për të gjithë artikujt e kerkuar në preventiv duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 8.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“Infosoft Office” shpk me adresë:** Adresa: Tiranë Kashar, Kodër Kashar, Autostrada Tiranë Durrës Km 8, se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **14,599,711 (katërbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.